



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPublika e KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Pranuar - Prindjeto Më/Dana 04-05-2022			
Nr. i organit Org. broj	Numri/Broj	Shënjëse Prilog	Vlera Vrednost
01	110/05	473	



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality Viti/na

Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, shkronja d të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 17 pika 2 lidhur me piken 6 të Ligjit për dhënie e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim nr.06/L-092, nenit 36, shkronja d të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë, në mbledhjen e mbajtur më datën 29.04.2022, merr këtë:

VENDIM

për formimin e Komisionit vlerësues dhe zbatimin e procedurave për dhënie e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim

Neni 1

Me këtë, Kuvendi i Komunës së Vitisë miraton vendimin për formimin e Komisioni për vlerësimin dhe zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim afat shkurtër të komunës së Vitisë lokalet me Nr.kadastrale P-70101007-02507-0-21-3-1-0, në sipërfaqe prej 65 m².

Komisioni propozohet pre 5 anëtarëve, dy nga ekzekutivi, dy kuvendi i komunës dhe një nga shoqëria civile dhe atë:

- Ahmet Arifi, anëtar i komisionit, përfaqësues i Ekzekutivit të Komunës;
- Sylë Salihu, anëtar i komisionit, përfaqësues i Ekzekutivit të Komunës;
- Ramadan Deliu, përfaqësues i Kuvendit të Komunës (subjekti LDK)
- Taulant Haxhiu, përfaqësues i Kuvendit të Komunës (subjekti PDK
- Melihate Osmani, përfaqësues i Sektorit jo qeveritar.

Neni 2

Me këtë vendim, detyrat e komisionit nga neni 1 i këtij vendimi janë përcaktuar në Ligjin për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr.06/L-092 i Kuvendit të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës me Nr.10, të datës 03.04.2019).

Komisioni vlerësues udhëheq me procedurat mbi dhënie e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim, si: përgatitë kriteret e ankandit, përcakton çmimin fillestar, vlerëson ofertat dhe ja propozon kuvendit ofertën ma të favorshme. Njësitë përkatëse të Administratës së Komunës i ofrojnë përkrahje Komisionit vlerësues.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen kryetari i Komunës, Drejtoria për Kadaster, Pronë dhe Gjeodezi dhe Drejtoria për Shërbime Publike e Komunës së Vitisë.

Neni 4

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, në kuptim të nenit 81 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 8, lidhur me neni 9 të Rregullores Nr.10/2019 për procedurat e hartimit dhe publikimit të akteve të komunave dhe pas publikimit në web faqen e Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Zyrës së Kryetarit, drejtorive;
2. Anëtarëve të komisionit;
3. MAPL-së; dhe
4. Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË

KRYESUESI
Bekim Azizi

